



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHE

Nr. _____ Prot.

Lezhe, më ____/____/2023

Shtojca 12

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT ¹
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Data 23/01/2023

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “ERALD-G” Shpk, me adrese Zyra në katin e parë, banesa 2-katëshe në lindje të fshatit herbel, Komuna Maqellarë, Diber.

Procedura e prokurimit/lotit: E Hapur e Thjeshtuar/ Sherbime.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-54972-12-23-2022.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Sherbimi i mbikqyrjes se punimeve me objekt “Rehabilitim i Shtetores dhe Lulishtes mbi lumin Drin”.

Kohëzgjatja e kontratës: 6 Muaj nga data e nenshkrimit te kontrates.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “ERALD-G” SH.P.K, me Nuis K36306784K dhe me oferte ekonomike 1,905,183.72 (një milion e nëntëqind e pesë mijë e njëqind e tetëdhjetë e tre pikë shtatëdhjetë e dy) Lek pa TVSH,
2. Operatori Ekonomik “MAGNA CHARTA” SH.P.K, me Nuis L92318021H dhe me oferte ekonomike 1,991,565 (nje milion e nenteqind e nentedhjte e nje mije e peseqind e gjashtedhjte e pese) Lek pa TVSH,
3. Operatori Ekonomik “MCE” SH.P.K, me Nuis L72203065K dhe me oferte ekonomike 1,905,183.73 (një milion e nëntëqind e pesëmijë e njëqind e tetëdhjetë e tre pikë shtatëdhjetë e tre) Lek pa TVSH
4. Operatori Ekonomik “NOVATECH STUDIO” SH.P.K, me Nuis L01717030C dhe me oferte ekonomike 1,853,178 (nje milion e teteqind e pesedhjte e tre mije e njeqind e shtatedhjte e tete) Lek pa TVSH,

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik “NOVATECH STUDIO” SH.P.K, me Nuis L01717030C,

Arsyet:

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE:

Se pari, Operatori ekonomik ka paraqitur oferten ekonomike nen vleren minimale te lejuar sipas percaktimeve të bëra në VKM nr. 354, datë.11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

KVO veren se operatorët ekonomike duhet te pergatisin oferten ekonomike ne perputhje me VKM-ne nr. 354, datë.11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” dhe vlera e ofertes ekonomike duhet te jete jo me e vogel se vlera minimale si dhe jo me e madhe se vlera maksimale e percaktuar ne perputhje me VKM-ne nr.354, datë.11.05.2016 ku parashikohet se: “*Tarifa për shërbimet duhet të jetë një vlerë ndërmjet tarifave minimale dhe maksimale, të përcaktuara në këtë manual, në përputhje me ligjin e prokurimit publik*”.

Nga verifikimi ne SPE, rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur oferte ekonomike me vlere me te ulet se vlera minimale e lejuar sipas percaktimeve te VKM-se nr.354, datë.11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Se dyti, nuk ploteson piken 2.3.4 ku parashikohet se: “*Ofertuesi duhet të ketë në stafin e tij, dhe të figurojnë në licencën e shqërisë (Drejtues teknik) përsonele si më poshtë:*

<i>a. Inxhinier Ndërtimi</i>	<i>1 (nje)</i>	<i>Diplome Universitare</i>
<i>b. Inxhinier Elektrik</i>	<i>1 (nje)</i>	<i>Diplome Universitare</i>
<i>c. Inxhinier Mekanik</i>	<i>1 (nje)</i>	<i>Diplome Universitare</i>
<i>d. Inxhinier Hidroteknik</i>	<i>1 (nje)</i>	<i>Diplome Universitare</i>
<i>e. Inxhinier Mjedisi</i>	<i>1 (nje)</i>	<i>Diplome Universitare</i>
<i>f. Inxhinier Topograf/Gjeodet</i>	<i>1 (nje)</i>	<i>Diplome Universitare</i>

-Per stafin e mesiperm Operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacionin si me poshte: Kontratë pune e vlefshme, Diploma Universitare, Liçencat profesionale përsonele të mbikëqyrjes si dhe të figurojnë ne listepagesat e kompanise se minimalisht per periudhen Shtator 2022 - Nentor 2022.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

KVO veren se bazuar ne piken 1, te nenit 26, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin

e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parshikohet se: *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, dhe për të permbushur këto kriter operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të vetedeklarojnë në formularin përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës perkatese të DST-se, të dhenat e stafit e mbështetës që disponon sipas përcaktimeve të mesiperme.*

Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetedeklarimit, rezulton se ky OE ka deklaruar disponimin e 1 (nje) inxhinier mjedisi Zj. Silvana Hila, por nga verifikimi i dokumentacionit bashkëngjitur në SPE vërehet se kjo e fundit është diplomuar në degen “Kimi Industriale”, si “Kimi Teknolog” pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës. KVO gjykon se megjithatë ky OE ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetedeklarimit disponimin e një inxhinier mjedisi si dhe duke qenë se ka bashkëngjitur në SPE diplomën e Zj. Silvana Hila, vërehet se OE nuk ka pasur si qëllim për të bërë deklaram të rreme me qëllim kualifikimi.

Theksojmë se për të permbushur pikën 2.3.4, OE-te, në lidhje me disponueshmërinë e një inxhinieri mjedisi duhet që një nga drejtuesit teknik të jetë i pajisur me diplomë për inxhinieri mjedisi të lëshuar nga një Fakultet Inxhinierik i cili ka program studimi për Inxhinieri Mjedisi.

Rrjedhimisht një drejtues teknik i diplomuar si Kimist-Teknolog nuk përmbush kërkesat e pikës 2.3.4, të DST-se pasi nuk disponon diplomë universitare si Inxhinier Mjedisi.

Sa me sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetur në nenin 76, pika 3/a dhe në nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në bazuar në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është

në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi te refuzoje oferten e Operatorit Ekonomik “NOVATECH STUDIO” SH.P.K, per mos permbushje te kritereve te vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Operatori Ekonomik “NOVATECH STUDIO” SH.P.K, me Nuis L01717030C, skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik “ERALD-G” Shpk, me adrese Zyra në katin e parë, banesa 2- katëshe në lindje të fshatit herbel, Komuna Maqellarë, Diber se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 1,905,183.72 (një milion e nëntëqind e pesë mijë e njëqind e tetëdhjetë e tre pikë shtatëdhjetë e dy) Lek pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë zyrese se protokollit te Bashkise Lezhe sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjete) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet siguri i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
KRYETARI
Pjerin NDREU
